

Platforma e Sindikates per Vendosijen e Boshtit Social ne
Komunitetin e Energjise ne Vendet e Europes Juglindore

Shkup, 17 Shtator 2005

PLATFORMA E SINDIKATES

Ne terheqim vemedjen drejt Traktatit te propozuar per krijimin e Komunitetit te Energjise ne vendet e Europes Juglindore. Ne do t'i kerkojme Parlamenteve dhe qeverite tona ta ratifikojne ate. Eksperimenti i hapjes se tregjeve te elektricitetit dhe gazit ne Bashkimin European eshte tregues i ndikimit negativ qe ato kane mbi punesimin, sigurine e furnizimit dhe koston e elektricitetit dhe gazit ne ekonomite shtepiake.

Propozimit te Komisionit European per politiken industriale i mungon dimensionimi i vertete social. Ai nuk merr parasysh problemet qe lidhen me punesimin, si trajnimi dhe kualifikimi, me rendesine qe ka mbrojtja e te drejtave te punetoreve dhe siguria ne vendin e punes, dialogu social, si faktore qenesore qe ecin krah per krah konkurrences. Per kete arsye ne jemi skeptike per perfitimet qe do te kene punetoret dhe qytetaret nga tregu i brendshem i elektricitetit dhe gazit.

Gjithesesi, nese vendoset nje bosht social, ne nuk i kerkojme as Parlamentit European dhe as Parlamenteve vendore te hedhin poshte Traktatin per Komunitetin e Energjise ne vendet e Europes Juglindore. Ne e pranojme kete Traktat si pjese te normave te komunitetit. Por ekuilibri humbet. Boshti social mungon. Ne kerkojme qe Komisioni European, Keshilli i Europes dhe qeverive tona te zotohen per vendosjen e ketij boshti/elementi social duke miratuar Memorandumin e Mirekuptimit, qe detajohet si me poshte:

- Pranimin e te Drejtave Themelore te Bashkimit European;
- Respektimin e normave me te domozdoshme sociale dhe te dialogut social, si rruget vetme per arritjen e tyre;
- Nevojen per Plan-veprime sociale kombetare qe do te shoqerojne zbatimin e Komunitetit te Energjise dhe burimet per realizimin e tyre;
- Procesin qe do te diskutoje plan-aksionet sociale;
- Ngritjen e nje Komiteti Drejtues me perfaqesues te qeverive, punedhenesve dhe sindikatave;
- Nje Moratorium mbi privatizimin e sherbimeve komunale, qe do te realizohet me nje debat te gjere publik, nese keto sherbime do te privatizohen, dhe ne rast se kjo ndodh - kushtet qe duhen permbushur.
- Njohjen e sindikatave si aksionere ne sektoret e elektricitetit dhe gazit ne vendet e Europes Juglindore dhe perfaqesimin tone ne Forumin Rregullator te Europes Juglindore;
- Lidhje te qendrueshme me Bordin Rregullator te Europes Juglindore, qe ka nje rol te vecante ne vendosjen e ketij boshti/elementi social.

Zbatimi i Traktatit dhe ngritja e tregut te brendshem do te kerkoje shume mund nga e nje numri organizatash. Procesi i realizimit te tij eshte shume i gjate. Qeverite dhe Komisioni European duhet te garantojne qe sindikatat, grupet e tjera te shoqerise civile (psh. ato qe mbrojne konsumatorin e varfer), komunitetet etj. do te luajne rolin e tyre dhe do te keqohen te japin informacion. Per kete qellim, duhet t'i lihet kohe e mjaftueshme dhe te gjenden burimet per te ndihmuar me ekspertizen e nevojshme si ne nivel kombetar ashtu edhe ne nivelin e Europes Juglindore.

Ne kerkojme qe Memorandumin te nenshkruhet njekohesisht me Traktatin ne menyre qe te sigurohet nje marredhenie e ekuilibruar.

Masa te tjera te nevojshme jane:

- Zbatimi i menjershem i konkluzioneve te takimit Parlamentar te Shkupit mbajtur ne datat 6-7 qershor 2005. Ketu perfshihen diskutimet me sindikatat dhe publikun.
- Permiresimi i kontrollit demokratik te institucioneve te Komunitetit te Energjise ne vendet e Europes Juglindore nepermjet nje kontrolli parlamentar me te qendrueshem. Nismetaret duhet te jene Parlamenti European dhe koordinatoret e Parlamenteve te Europes Juglindore.

Parathenie

Ne, sindikatat e elektricitetit dhe gazit ne Europen Juglindore qe perfaqesojme punetoret e ketij sektori, u mblodhem ne Shkup me 17 shtator 2005 per te analizuar/shqyrtuar nderlikimet/pasojat qe sjell Traktati i Energjise per vendet e Europes Juglindore. Ky Traktat do te percaktoje ngritjen e tregut te brendeshem per elektricitetin dhe gazin, bazuar ne Direktivat e Bashkimit European mbi tregun e brendshem per elektricitetin dhe gazin, si edhe ne ligjin dhe rregulloren e Bashkimit European mbi konkurrencen.

Zbatimi i Traktatit te Energjise ne Europen Juglindore eshte nje proces ne vazhdim. Ne e shohim kete proces. Ai eshte me pasoja per jeten tone dhe per menyren se si ne punojme, pavaresisht se nuk ishim ne ata qe e kerkuam kete proces. Ne duam te garantojme nje input te forte sindikal dhe te ngreme zerin tone per te perfaqesuar interesat e anetareve dhe qytetareve tane ne Europen Juglindore. Qellimi yne eshte t'i bashkangjisim nje element/bosht social ketij Traktati.

Bashkepunimi per problemet e energjise ne Europen Juglindore eshte nje nisme e mirepritur, qe ndihmon ne sigurimin e paqes dhe stabilitetit ne rajonin tone kaq problematik. Qellimi i ketij Traktati, permiresimi i furnizimit me energji dhe mbrojtja e mjedisit, ka po aq rendesi sa edhe perpjekjet e nderkombetareve per te bere investime ne rajon me qellim permiresimin e infrastruktures se rjetit energjetik. Kjo do te siguronte zhvillimin e industrive, sherbimeve, ekonomive tona dhe do te sillte perfitime per biznesin dhe qytetaret.

Por pyetja qendron nese masat qe parashikon Traktati jane zgjidhja me e mire per rajonin tone. Ne jemi dyshues/skeptike persa i perket leverdise se konkurrences ne sektoret e elektricitetit dhe gazit per shkak te shtrengesave/kufizimeve sociale, fizike dhe ekonomike si edhe problemeve qe ka pasur se fundmi vete Bashkimi European. Padyshim qe elektriciteti eshte nje e mire sociale themelore per shoqerite moderne. Ne vleresojme se energjia eshte pjese e bashkesise globale dhe publike. Parimi qe na udheheq eshte se nevojat e njeriut jane me te rendesishme se fitimi financiar. Industrite dhe sherbimet moderne mbeshteten ne furnizimin e sigurt dhe te vazhdueshem me energji dhe gaz. Nje bashkepunim dhe bashkerendim me i mire krahas nje kuadri te qarte ligjor do te siguronte krijimin e nje kuadri te qendrueshem per investime afatgjata. Traktati dhe konkurrenca qe ai parashikon permbajne ne vetvete rrezikun dhe per pasoje nje premium/kosto investimi, qe do te ngrinte cmimin e energjise, gje qe bie ne kurriz te qytetareve dhe biznesit.

Sektori i energjise ne Europe eshte ne evolucion te plote. Liberalizimi i tregut te elektricitetet dhe gazit dhe procesi i perqendrimit me te ane te se ciles kompanite kerkojne te bejne ndryshime te medha dhe te nxituara ne kete sektor, do te thote rrenim i vendeve te punes direkt dhe indirekt permes pershpejtimit dhe mbylljes se shume ndermarrjeve.

Hartimi i nje politike per energjine ne Europen Juglindore duhet te jete gjithperfshires dhe te beje te qarte pasojat e zgjedhjeve industriale dhe ekonomike te cilat ndikojne ne punesim, garancite sociale, ne shendetin dhe sigurine ne pune, ne kushtet e punes, planifikimin rajonal, ne investimet afatgjata dhe mjedis.

Pervoja e Bashkimit European persa i perket humbjes se vendit te punes eshte shume shqetesuese. Mbi 300.000 vende pune jane mbyllur ne 10 vitet e fundit. Teksa jepen argumente se rendimenti eshte rritur, kjo do te ishte e kote pa folur per ndikimin qe ai ka ne efektivitetin dinamik afatgjate, gje qe minon parimin kryesor te drejtimit ekonomik mbi te cilin bazohet konkurrenca ne sektorin e energjise. Humbja e vendit te punes godet komunitetin lokal, sidomos ne vendet qe kane papunesi te madhe. Bazuar ne pervojen e BE-se, ne vitet qe vijne ne parashikojme humbjen e 25-30% te vendeve te punes ne sektorin e elektricitetit dhe gazit ne Europen Juglindore. Nje studim i Bankes Boterore (Mars 2004) parashikonte shkurtimin e 100.000 vendeve pune ne minierat e qymyrit per t'i bere ato ekonomikisht rentabel. Ky eshte nje program per mjerim, varferi afatgjate krahas pasojave qe ai shkakton, te tilla si probleme shendetesore dhe kriminalitet ne disa zona. Planet sociale me shtrirje te gjere dhe fondet per te mundesuar realizimin e tyre mungojne ne shume vende.

Tregu i elektricitetit dhe gazit do te coje ne rritjen e cmimeve si per konsumatoret e medhenj industriale ashtu edhe per konsumatoret shtepiake. Parashikohet se ndihmat/subvencionet nuk do te jepen. Cmimi i elektricitetit dhe gazit do te reflektoje koston e vet reale. Per kete arsye, gjendja ne treg dhe mungesa e karburantit jane shqetesimet tona kryesore, te cilat duhet t'i behen me dije qeverive perkatese. Kjo duhet te behet ne rruge publike dhe permes konsultimeve te gjera.

Ky Traktat eshte negociuar nga qeverite tona dhe nga Komisioni European ne menyre te fshehte. Sindikatat dhe grupet e tjera te shoqerise civile nuk kane ndikuar ne te. Kjo duket sheshit. Mungesa e nje boshti social flet per injorimin qe u behet halleve dhe problemeve te punetoreve dhe qytetareve. Traktati kerkon qe qeverite tona te zbatojne normat Europiane mbi mjedisin, energjine si edhe ligjet dhe rregullat e konkurrences. Por nuk thuhet as edhe nje fjale per normat sociale te BE-se. Kjo eshte e papranueshme. Bashkimi European eshte me shume se thjeshtc nje konkurrence. Ai nenkupton gjithashtu nje model social.

Mesazhi yne: Ne nuk e kundersizojme Traktatin perderisa boshti social mungon

Qeverite tona dhe Komisioni European tashme jane marre vesh per Traktatin. Se shpejti ai do te diskutohet ne Parlamentin European dhe ne Parlamentet e vendeve perkatese qe me pas te ratifikohet. Pavaresisht nga kritikate tona themelore, ne nuk kerkojme qe Parlamenti European ta hedhe poshte Traktatin. Padyshim, ai pasqyron nje pjese te normave te BE-se. Por duhet marre nje zotim per perfshirjen e elementit/ boshtit social dhe procesit te nevojshem per ta arritur kete. Nje Komunitet Energjie qe i mungon boshti social eshte i papranueshem.

Kujtojme se normat e energjise dhe konkurreces per Shtetet e reja anetare te BE-se, Bullgarine dhe Rumanine, shoqerohen me zbatimin e normave sociale. Kjo eshte metoda e ekuilibruar e Modelit Social European.Traktatit te Energjise ne vendet e Europes Juglindore i mungon ky ekuiliber.

Qeverite dhe Komisioni European kane refuzuar t'i degjojne kerkesat tona per perfshirjen e boshtit social ne Traktat. KE-ja aktualisht po pergatit nje Memorandum mbi boshtin social.Ky Memorandum do t'i bashkohet Traktatit. Komisioni, Keshilli, qeverite tona dhe parlamentet do te marrin angazhime per kete Memorandum. Nese ai nuk aprovohet, Traktati do te jete nje sinjal i keq per rajonin tone. Ne kerkojme qe Traktati te aprovohet dhe te nenshkruhet njekohesisht me Traktatin mbi Energjine, ne menyre qe te jape nje mesazh te qarte politik per punetoret dhe qytetaret e rajonit.

Kerkesat tona per Memorandumin

- Plan-aksionet sociale

Dokumenti mbi Strategjine afatgjate per zbatimin e Traktatit te hartuar nga komisioni mbi Energjine ne Europen Juglindore, kerkon qe qeverite te percaktojne nje plan-aksion social qe do te realizohet krahas zbatimit te Traktatit mbi Energjine ne vendet e Europes Juglindore. Kjo eshte nje ide pozitive, te cilen ne e mbeshtesim. Qeverite duhet ta konsultojne kete plan-veprim social me sindikatat dhe grupe te tjera.

Elementet kyc te planit social duhet te jene:

- Shqyrtimi i nderlikimeve/pasojave sociale si rezultat i procesit te ristrukturimit;
- Ndalimi i pakesimit/mungeses se karburantit;
- Te merren masa ne menyre qe pjesa e varfer e shoqerise te mos bjere viktime e konkurreces;
- Te tregohet kujdes per pasojat e shkaktuara nga mosdhenia e subvensioneve, perfshi konsumatoret e medhenj ne industri, dhe per zbutjen e ketyre pasojave.

Qeverite e vendeve te Europes Juglindore duhet te nisin konsultimet per zbatimin e ketyre Plan-Aksione sociale menjehere pas nenshkrimet te Traktatit. Ky eshte nje sinjal pozitiv qe tregon se problemet sociale po trajtohen seriozisht. Detyra e Komisionit eshte qe se bashku me Komitetin Drejtues te monitoroje zbatimin e Plan-Aksioneve Sociale.

Ky angazhim duhet te perfshihet ne Memorandum.

- **Dialogu Social**

Ne te njejten menyre ne mirepresim faktin qe dokumenti i Komisionit mbi Strategjine argumenton se pasojat sociale te Strategjise ne Tranzicion duhet te analizohen me tej me ane te dialogut social. Ceshjtjet qe trajton Dokumenti mbi Strategjine, midis te tjerash, jane pasojat ne:

- Punesimin direkt dhe indirekt
- Aftesite dhe kualifikimin
- Tarifat per ekonomite shtepiake (dhe ato me te prekshmet)

- Kontrolli demokratik i drejtimit te ardhshem te sistemit energjistik

Dokumenti thekson se duhen marre masa per gjenerimin e punesimit dhe per programet e trajnimit. Dokumenti mbi Strategjine e Energjise kerkon qe qeverite te paraqesin masa shoqeruese dhe zbutese per te zvogeluar pasojat negative sociale te ristrukturimit. Memorandumi duhet t'i perfshije keto ceshtje.

- **Komiteti Drejtues**

Nje sugjerim tjetër interesant ne lidhje me dokumentin mbi strategjine eshte ideja e krijimit te nje Komiteti Drejtues me perfaqesues te qeverive, kompanive te punemarresve dhe sindikatave, i cili do te ndjeke zbatimin e Traktatit mbi Energjine ne vendet e Europes Juglindore. Komiteti Drejtues duhet te beje propozime per pasojat sociale dhe sugjerimet e tij duhet te shqyrtohen nga bordi rregullator. Ky eshte nje propozim i mirepritur pasi ndihmon per vendosjen e boshtit social te Komunitetit te Energjise, qe do te ishte nje sherbim me shume ne drejtim te arritjes se stabilitetit dhe kohezionit social. Ne e konsiderojme kete si pergjigjen sociale per institucionet e energjise qe parashikon Traktati.

Komisioni Europian dhe/ose Pakti i Stabilitetit duhet te marrin masat e nevojshme per krijimin e Komitetit Drejtues dhe hartimin e planit te punes. Edhe ne kete rast, ne duam qe kjo kerkese te pasqyrohet ne Memorandum.

- **Normat e domozdoshme sociale**
- Te drejtat themelore

Qeverite tona duhet te njohim Karten e te Drejtave Themelore te BE-se (Traktatin e Nises). Karta njeh te drejtat themelore te sindikatave te percaktuara edhe ne Karten Sociale te Keshillit te Europes dhe ne te Drejtat Themelore te Organizates Nderkombetare te Punes/ILO. Te drejtat themelore perfshijne te drejten per krijimin e shoqatave te punetore dhe te drejten per t'u perfaqesuar nga nje organizate sindikale, te drejten per informacion dhe keshillim, te drejten per kontrate kolektive dhe per greve.

Ne besojme se eshte shume e rendesishme qe normat sociale te zbatohen permes procesit te dialogut social (perfshi negociatat).

- Te drejtat themelore
- Dialogu social
- Direktivat per krijimin e kuadrit shendetsor dhe te sigurise ne pune
- Direktivat per kohen e punes
- Direktivat per barazine
- Shkurtime kolektive, Transferimi i Sipermarreve dhe Direktivat qe lidhen me to
- Direktivat mbi Informacionin dhe Konsultimet (perfshi EWC-te)
- Direktivat mbi Paaftesine e punedhenesve per te paguar

Angazhimi/zotimi per te vene ne jete normat e duhura sociale duhet te perfshihet ne Memorandum.

- **Dialogu Social**

Permes Memorandumit, si qeverite ashtu edhe Komisioni European duhet te angazhohen per realizimin e procesit te dialogut social me sindikatat dhe punedhensesit, qe do te zhvillohet krahas zbatimit te Traktatit. Kjo do te thote:

Dialog ne nivel local, sektorial, kombetar dhe European. Partneret sociale Europiane (sindikatat dhe punedhensesit) ne sektorin e elektricitetit i kane bere thirrje Komisionit European qe te perfshije partneret sociale te rajonit ne dialogun e tyre social sektorial European. Komisioni duhet te gjeje burimet e nevojshme per ta mbeshtetur kete. Partneret sociale te elektricitetit kane shume pervojte. Kemi parasysh ketu Deklaraten e Budapestit. Kemi pasur shume raste kur sindikatat ne rajon na jane ankuar se qeverite nuk angazhohen ne procesin e dialogut social mbi procesin e ristrukturimit rrenjesor te ketij sektori. Megjithate, vihen re shembuj te praktikave me te mira nga te cilat ne duhet te mesojme.

Procesi i dialogut social midis punedhensesve dhe sindikatave mund te ndihmoje qe ne bashkepunim me qeverite te pergatiten dhe te zbatohen (edhe me ane te marreveshjeve kolektive) normat e duhura sociale, mundesisht se pari per sektorin e elektricitetit dhe gazit. Kjo ben qe sektori i energjise te radhitet krahas BE-se nepermjet nje procesi gradual.

Komisioni European duhet ta ndihmoje procesin me burimet e nevojshme, perfshi ekspertizen e partnereve sociale.

Klauzola pa prapaveprim

Memorandumi duhet te perfshije nje klauzole pa prapaveprim ne menyre qe standartet te mos jene me te ulta se standartet ligjore ekzistuese. Gjithashtu, Memorandumi duhet te garantoje qe procesi nuk do te shfrytezohet per te dobesuar dhe minuar marreveshjet kolektive ekzistuese ne sektor.

Ristrukturimi, Privatizimi dhe Sherbimet zhvilluese me interes te pergjithshem

Hapja graduale e tregjeve te elektricitetit dhe gazit ne Europen Juglindore kerkon percaktimin e rregullave te reja per funksionimin e sherbimeve publike, ndryshe te quajtura sherbime me interes te pergjithshem, me qellim qe motivi i fitimit te mos jete faktor mbizoterues ne dem te punesimit, garancive sociale, shendetit publik dhe rritjes ekonomike, si edhe ne interes te te gjithe konsumatoreve.

Duhet te garantohet akses i barabarte i te gjithe qytetareve per energji me cmime te perballueshme pavaresisht nga statusi ligjor (publik apo privat) i kompanive.

Ne perserisim kerkesen tone per nje Moratorium mbi Privatizimin e sherbimeve komunale te elektricitetit dhe gazit. Tregu i brendshem per elektricitet dhe gaz nuk i ve ne detyrim qeverite tona qe te bejne privatizime, po ashtu as Komisioni European nuk i detyron qeverite per kete gje. Per shembull, ne Bashkimin European ka shume ndermarrje publike (shteterore apo komunale). Ne verejme se ai qe konsiderohet si tregu me funksional i elektricitetit (tregu Nordik) bazohet gjeresisht ne kompanite me pronesi publike. Sherbimet me cilesi te larte, siguria e furnizimit dhe interesat e publikut permbushen me se miri permes sherbimeve, te cilat do t'i rezistojne privatizimeve te bera se prapthi.

Ne jemi te ndergjegjshem per faktin se qeverite shpesh nuk bien dakord per privatizimet. Dihet se privatizimet (ose te ashtuquajturat partneritete publike-private) duhen pt te pergatiten sic duhet duke marre parasysh interesa te shumta e te ndryshme. Kjo nuk ndodh shpesh.

Memorandumi duhet te perfshije nje Moratorium mbi privatizimin. Ai duhet te percaktoje qe:

- Perpara se te kryhet privatizimi, duhet te zhvillohet nje debat i gjere publik ne shoqeri, ne menyre qe qytetaret te krijojne pershtypjet e tyre. Kjo faze duhet te perfshije zhvillimin e seancave ne Parlamentet vendore. Sindikatat dhe grupet e tjera te shoqerise civile duhet te jene ne gjendje te hartojne ekspertiza (kunderekspertiza) ne perputhje me keshilla te specializuara (me te shumten ne drkombetare), qe qeverite kerkojne nga konsulentet. Ka raste kur referendumi behet nje instrument i vlefshem per te testuar opinionin e publikut.
- Para se te kryhet privatizimi te gjitha institucionet duhet te angazhohen per te siguruar nje mbikqyrje demokratike, nje kuader ligjor te qarte dhe per te ndaluar shfrytezimin e punetoreve dhe qytetareve.
- Para privatizimit duhet te behet vlesesimi i pasojave qe ai do te kete mbi punetoret, te vobektit, qytetaret, financat publike, mjedisin, investimet dhe cmimet.

Ne rast se privatizimi kryhet mbi bazen e praktikave pozitive te Shteteve te reja Anetare, duhet aprovuar nje pakete sociale per mbrojtjen e punetoreve dhe qytetareve nga kerkimi i ethshem i kompanive per fitim. Paketa sociale duhet te jete pjese e tenderave dhe lishencave qe u jepen pronareve te rinj per te operuar sherbimet.

Keto paketa sociale duhet te diskutohen dhe negociohen me sindikatat.

Paketat sociale duhet te sigurojne mbrojtje per qytetaret e vobekte ne menyre qe ata te mos privohen nga sherbimet themelore.

Midis te tjerash, paketa sociale duhet te permbaje:

- Njohjen e sindikatave te interesuara
- Garanci per respektimin e marreveshjeve kolektive dhe standarteve te tjere sociale. Pronaret e rinj duhet te anetaresohen ne organizatat kombetare te punedhenesve aty ku eshte e mundur (ne rastet e marreveshjeve kolektive sektoriale kombetare)
- Garanci per punesim
- Trajnim dhe masa te tjera per te siguruar krahe pune te kualifikuar
- Trajnim dhe marrjen e masave per ri-punesim e atyre punetore qe kane humbur punen
- Mbylljen e burimeve dhe kushtet e kesaj mbyllje, perfshi negociatat dhe respektimin e marreveshjeve kolektive
- Dialogun social dhe te drejten per informacion dhe keshillim
- Metoden per zhvillimin e dialogut dhe negociatave (ne nivel sektorial dhe lokal)

- Garanci qe mandati i sindikates i jep asaj te drejten te mos lejoje pronaret e rinj te zbehin zerin e punetoreve duke i flakur tej perfaqesuesit e tyre
- Rregullat per Pronesine e Punetoreve (aksionet) qe lidhen me te drejten per te degjuar zerin e aksionereve punetore. Duhet te mundesohet kombinimi i aksioneve te punetoreve ne fondet e aksioneve te punetoreve.
- Pjesemarrjen ne Keshillat Europiane te Punes. Punetoret ne vendet e Europes Juglindore nuk jane punetore te rangut te dyte

Bordet rregullatore duhet te luajne nje rol te rendesishem ne mbikqyrjen e respektimit te ketyre paketave sociale nga kompanite. Nese ato (kompanite) nuk i respektojne keto paketa sociale, atehere u hiqet lishenca.

Edhe kompanite publike po ristrukturohen. Sikurse edhe ne rastin e pronareve te rinj, duhet te kete paketa sociale qe sigurojne kryerjen e ristrukturimit ne rruge te pranueshme sociale. Kjo ishte edhe pjese e diskutimit Europian mbi ristrukturimin kohet e fundit.

Kjo ceshtje duhet te perfshihet ne Memorandum.

- **Te permiresohet kontrolli demokratik mbi Komunitetin e Energjise**

Institucionet qe do t'i bashkohen Komunitetit te Energjise ne Europen Juglindore i nenshtrohen nje kontrolli te vaket parlamentar si ne nivel kombetar ashtu edhe Europian. Ne besojme se raportet vjetore qe i paraqiten Keshillit Ministror nuk arrijne te sigurojne/kryejne nje kontroll te rrepte demokratik.

Ne kerkojme qe parlamentet vendore dhe Parlamenti Europian te ngrene nje grup kontrolli parlamentar europian qe do te ushtronte kontroll mbi Keshillin Ministror ne menyre te perhershme. Vendimet e marra nga Keshilli Ministror duhet t'i paraqiten ketij grupi per shqyrtim dhe amendime/ndryshime te mundshme. Kjo kerkon zbatimin e nje procedure transparente. Propozimet per marrjen e vendimeve duhet te behen publike ne menyre qe edhe organizata te tjera te mund te paraqesin pikepamjet e veta. Parlamenti Europian dhe parlamentaret e Europes Juglindore duhet te marrin nisma ne kete drejtim me qellim qe procedurat te jene te rregullta pas ratifikimit te parashikuar ne mes te vitit 2006.

Koordinatorja e parlamentareve te Europes Juglindore, Dr. Vesna Borozan, na njohu me Traktatin. Ne e vleresojme shume kete fakt. Ajo iu referua konkluzioneve te Takimit te Parlamentareve ne Shkup (7 qershor 2006). Midis te tjerash parlamentaret rane dakord per:

- Per hartimin e nje list-kontrolli per zbatimin e normave. Ky eshte nje propozim i goditur. Ne deshirojme qe list-kontrolli te pasqyroje edhe normat sociale qe ne mendojme se jane te domozdoshme per sektorin e energjise, sikurse thuhet ne kete Platforme te Memorandumit.
- Per bashkepunimin me sindikatat dhe shoqerine civile. Ne e mirepresim kete angazhim te parlamentareve. Ai perben nje hap te rendesishem per njohjen e sindikatave. Ne kerkojme qe parlamentaret te diskutojne me ne dhe me grupet

e tjera te shoqerise civile,ne nivel kombetar dhe European, mbi menyren e realizimit dhe organizimit te ketij bashkepunimi.

- Per zhvillimin e séancave publike ne parlament. Ne e mirepresim kete konkluzion te parlamentareve dhe kerkojme nisjen e menjehershme te pergatitjeve per organizimin e seancave. Per shume vende ky do te jete rasti i pare per zhvillimin e nje debati te gjere publik. Nderlikimet/pasojat qe sjell zbatimimi i Traktatit duhet te jene ne qender te diskutimeve.
- Kerkese per mbeshtetje konkrete dhe fonde nga BE-ja per zbatimin e Traktatit. Ne jemi dakord. E rendesishme eshte qe Traktati te lere hapesire per:
 - Garanci per investime afatgjate nga BE-ja
 - Te drejten/aksesin e rajonit per fonde sociale europiane dhe instrumentet e tyre me qellim nxitjen e zhvillimit dhe punesimit, si edhe kurimin e pasojave negative qe shkatohen nga krijimi i tregut te brendshem
 - Gjetjen e burimeve per krijimin e rrjeteve te parlamentareve, sindikatave dhe grupeve te tjera te shoqerise civile me qellim monitorimin e zbatimit te Traktatit, ngritjen e problemeve dhe propozimin e zgjidhjeve. Keto rrjete duhet te jene ne gjendje te terheqin ekspertizen. Ne besojme se keto masa do te kontribojne per nje kohezion dhe stabilitet me te madh ne Europen Juglindore.
 - Krijimin e nje bordi te qendrueshem parlamentaresh, qe do te pergjigjet per energjine, ujin dhe infrastrukturen. Edhe kjo nisme eshte shume e vlefshme. Ne kerkojme qe parlamentaret te diskutojne me ne per rruget e krijimit te nje marredhenie afatgjate, gje qe do te ishte ne dobi te punes se parlamentareve, do t'i jepte shtyese zhvillimit te demokracise dhe kontrollit demokratik dhe do te kontribonte ne arritjen e stabilitetit dhe punesimit ne rajon.

•Rregullatoret dhe boshti/elementi social

Traktati parashikon ngritjen e nje Forumi rregullator dhe liston nje sere aksioneresh. Por ketu nuk figurojne as sindikatat dhe as partneret sociale (sindikatat dhe punedhenesit).Ne kerkojme qe sindikatat te njihen formalisht si aksionere. Memorandumi duhet ta vere ne dukje kete fakt.Ne do te sigurojme nje ze perfaqesues ne Forum.

Komisioneri Bullgar i Komisionit Shteteror Rregullator per Energjine dhe Ujin, Valery Vlatchkow, na informoi per punen e e rregullatoreve.Ne e vleresojme shume kete dhe mendojme se ka shume rendesi te krijojme nje marredhenie konstruktive me rregullatoret.

Memorandumi duhet te shqyrtoje dhe te paraqese dokumentin e Komisionit mbi strategjine afatgjate, ne menyre qe aty ku eshte e mundur rregullatoret te perfshijne direktiva/udhezime sociale ne punen e tyre.

Ne kerkojme qe Komisioni dhe rregullatoret e Europes Juglindore te ofrojne shembuj nga praktikat e tyre me te mira dhe rruget e konsultimit te sindikatave dhe grupeve te tjera te shoqerise civile. Pe kete qellim, Memorandumi duhet te perfshije propozime.

Ne kerkojme qe konsultimet te behen sipas nje strukture te caktuar, psh. qe sindikatat te marrin pjese direkt ne punen e rregullatoreve (si anetare te bordit ose te komiteteve) permes bordit apo komiteteve keshillimore, ose permes rrugeve te tjera stukturore.

Pjesemarrja demokratike ne punen e rregullatoreve ben qe ata te mos degjojne vetem njeran ane te problemit (shpesh ate te pjesemarrësve qe kane burime te mjaftueshme financiare).

Puna e rregullatoreve duhet te jete transparente. Rregullatoret duhet te jene te pavarur nga qeverite dhe industrite.

Puna e rregullatoreve eshte gjithepershiresë: nga nxitja e konkurrences ne nxitjen e mbrojtjes se konsumatorit, ne sigurine e furnizimit, ne besueshmerine dhe standartet mjedisore.

- Investime ne rrjete dhe kapacitet
- Investime ne mirembajtje dhe riparime
- Kontrolli i lishencave dhe kontratave ne menyre qe stafi i duhur, i kualifikuar dhe i mire-trajnuar te siguroje sherbime me cilesi te larte dhe besueshmeri

Regullatoret duhet te jene ne gjendje te verifikojne lidhjet midis sherbimeve komunale dhe nenkontraktoreve (dhe nen-nenkontraktoreve) per te percaktuar pergjegjesite qe ata kane.

Memorandumi duhet te perfshije propozimin qe Bordi Rregullator i Europes Juglindore dhe sindikatat te zhvillojne nje dialog afatgjate gjate procesit te zbatimit te normativave Europiane.

- **Ndjekja direkte e problemeve te konferences tone**

Zbatimi i Traktatit te Energjise te Europes Juglindore eshte nje proces ne zhvillim. Ai eshte me pasoja per ne dhe per menyren se si ne punojme. Ne deshirojme te sigurojme nje ze te forte sindikal dhe informacion sindikal per te perfaqesuar interesat e anetareve tane dhe qytetareve te Europes Juglindore me vendosjen e boshtit/elementit social ne Komunitetin e Energjise ne vendet e Europes Juglindore.

Ne zotohemi te bashkepunojme ne menyre konstruktive me Komisionin e Europes, me qeverite dhe me institucionet e Komunitetit te Energjise ne Europen Juglindore, per te vendosur boshtin social ne Komunitetin e Energjise te Europes Juglindore. Ne kerkojme nje perkushtim te njejte nga ana e tyre per te punuar me ne.

Ne zotohemi per sa me poshte:

Ne do ta botojme kete Platforme te kerkesave sindikale ne gazetate e sindikatave tona, ose ne websitin tone dhe do te informojme anetaret tane per perpjekjet tona te perbashketa per te vendosur nje bosht social.

- Ne do ta cojme kete Platforme te sindikatave ne vemendjen e qeverive dhe te anetareve te Parlamenteve tona vendore.
- Do te kerkojme vemendjen e medias lokale dhe kombetare ndaj kerkesave tona

- Do te eksplorojme interesa te perbashketa me grupe te tjera te shoqerise civile
- Do te kontaktojme me koordinatoret e parlamentareve te Europes Juglindore me qellim qe te terheqim vemendjen e tyre drejt Platformes tone
- Do te lidhemi me Parlamentin European, i cili do te marre ne shqyrtim Traktatin ne javet qe vijne
- Ne i kerkojme Komisionit t'i paraqese kerkesat tona ne Memorandumin qe po pergatitet

Gjithashtu, ne do te ngreme nje grup koordinimi me perberjen e koordinatoreve kombetare dhe me mbeshtetjen e federatave sindikale europiane te interesuara: EPSU/EMCEF dhe ETUC per te ndjekur dhe percjelle procesin.
